

NJOFTIM PËR TË DREJTAT E PUNËMARRËSIT PËR DADOT E FËMIJËVE, PASTRUESIT E SHTËPIVE DHE PUNONJËSIT E TJERË SHTËPIAKË

Mbështetur në ligjin e Qytetit të Nju-Jorkut "Për kohën e paguar për arsye sigurie dhe shëndetësore" (ligji "Për lejen e paguar për arsye sigurie dhe shëndetësore"), punonjësit shtëpiakë gëzojnë të drejtën e lejes për arsye sigurie dhe shëndetësore. Vizitoni nyc.gov/PaidSickLeave për të mësuar më shumë rreth ligjit.

Punonjësit shtëpiakë që punojnë drejtpërdrejt për punëdhënës individë familjarë duhet ta marrin këtë njoftim me shkrim nga punëdhënësi i tyre në momentin kur fillojnë punë ose deri më 4 qershor 2018, cilado qoftë data më e vonë.

JU GËZONI TË DREJTËN E PUSHIMIT PËR ARSYE SIGURIE, të cilën mund ta përdorni për të kërkuar ndihmë ose për të marrë masa të tjera sigurie nëse ju vetë apo një anëtar i familjes mund të jetë viktimë e një akti apo kërcënimi të dhunës në familje ose të kontaktit seksual kundër dëshirës, përndjekjes apo trafikimit të qenieve njerëzore.

JU GËZONI TË DREJTËN E PUSHIMIT PËR ARSYE SHËNDETËSORE, të cilën mund ta përdorni për t'u kujdesur dhe trajtuar veten ose një anëtar të familjes.

PUNONJËSIT SHTËPIAKË QË MBULOHEN/NUK MBULOHEN NGA LIGJI:

Mbulohen	Nuk mbulohen
<p>Ju <i>jeni</i> një punonjës shtëpiak që mbulohet nga ligji nëse jeni punësuar direkt nga një familje dhe:</p> <ul style="list-style-type: none"> Kujdeseni për fëmijët Kujdeseni për një person të moshuar, të sëmurë, me aftësi të kufizuara ose në rehabilitim shëndetësor Kryeni shërbime që lidhen me punët e shtëpisë, si p.sh. gatimi dhe pastrimi 	<p>Ju <i>nuk</i> konsideroheni "punonjës shtëpiak" siç e parashikon ligji dhe për rrjedhojë nuk mbuloheni nëse detyrat e përshkruara në kolonën 1 i kryeni për një familje nëpërmjet një agjencie punësimi.</p> <p>Në zbatim të ligjit, punonjësit e punësuar nga agjencitë mund të gëzojnë deri në 40 orë leje të paguar për arsye sigurie dhe shëndetësore. Vizitoni nyc.gov/PaidSickLeave për të mësuar më shumë rreth punëmarrësve që mbulohen siç e parashikon ligji. Ju mund të konsideroheni "punonjës shtëpiak" për qëllimet e ligjeve të Shtetit të Nju Jorkut dhe të gëzoni të drejtën për mbrojtje shtesë.</p>

KOHËZGJATJA E PUSHIMIT PËR ARSYE SIGURIE DHE SHËNDETËSORE:

- Pas një viti punësim, punëdhënësi juaj duhet t'ju japë çdo vit dy ditë leje të paguara për arsye sigurie dhe shëndetësore. "Leja nga qyteti" është në shtesë të tri ditëve leje të paguara, që ju mund të gëzoni bazuar në ligjin e Shtetit të Nju-Jorkut. Për më shumë informacion rreth të drejtave tuaja sipas ligjit të Shtetit, vizitoni labor.ny.gov dhe kërkoni "Domestic Workers' Bill of Rights" (Akti për të drejtat e punonjësve shtëpiakë).

DATA E DISPONUESHMËRISË PËR PËRDORIMIN E PUSHIMIT PËR ARSYE SIGURIE DHE SHËNDETËSORE:

- Ju mund të filloni përdorimin e lejes për arsye shëndetësore nga data 1 prill 2015 ose një vit pas punësimit tuaj, cilado datë të jetë më e vonë.
- Ju mund të filloni përdorimin e lejes për arsye sigurie nga data 5 maj 2018 ose një vit pas punësimit tuaj, cilado datë të jetë më e vonë.

ARSYET E PRANUESHME PËR TË PËRDORUR PUSHIMIN PËR ARSYE SIGURIE DHE SHËNDETËSORE:

Ju mund ta përdorni pushimin për arsye sigurie dhe shëndetësore dhe të liroheni nga puna atëherë kur:

- Keni një sëmundje mendore ose fizike, lëndim ose gjendje shëndetësore; ju nevojitet të kryeni një diagnostikim mjekësor, kujdes apo trajtim për sëmundjen tuaj mendore ose fizike, lëndimin apo gjendjen shëndetësore; ju nevojitet të merrni kujdes mjekësor parandalues.
- Ju duhet të kujdeseni për një anëtar të familjes që ka nevojë për diagnostikim mjekësor, kujdes apo trajtim për një sëmundje mendore ose fizike, lëndim apo gjendje shëndetësore, ose që ka nevojë për kujdes mjekësor parandalues.
- Biznesi i punëdhënësit tuaj mbyllet për shkak të një emergjence të shëndetit publik ose kur ju duhet të kujdeseni për një fëmijë kopshti ose çerdhja e të cilit është e mbyllur për shkak të një emergjence të shëndetit publik.
- Ju ose një anëtar i familjes tuaj mund të jeni viktimë e një akti apo kërcënimi të dhunës në familje ose kontaktit seksual kundër dëshirës, përndjekjes apo trafikimit të qenieve njerëzore dhe ju duhet të merrni masat e nevojshme për të rikthyer shëndetin ose sigurinë fizike, psikologjike ose ekonomike tuaj apo të anëtarëve të familjes suaj, ose për të mbrojtur ata që shoqërohen ose punojnë me ju, duke përfshirë edhe për:
 - Të marrë shërbime nga një strehë mbrojtëse ndaj dhunës në familje, nga një qendër për krizat e përdhunimit ose nga program tjetër shërbimesh.

- Të marrë pjesë në planifikimin e sigurisë, zhvendosjen ose marrjen e masave të tjera për të mbrojtur sigurinë tuaj ose të anëtarëve të familjes suaj, duke përfshirë edhe regjistrimin e fëmijëve në një shkollë të re.
- Të takuar një avokat ose ofrues të shërbimeve sociale për të marrë informacion dhe këshilla lidhur me kujdestarinë, vizitat, çështjet martesore, urdhrat e mbrojtjes, emigrimin, strehimin, diskriminimin në punësim, kreditë për strehim apo ato konsumatore.
- Të paraqitur pranë agjencive ligjzbatuese një raport incidenti në familje ose për një takim në zyrën e prokurorit të distriktit.

ANËTARËT E FAMILJES:

Ligji njeh si "anëtarë të familjes" individët më poshtë:

- Çdo individ lidhja e ngushtë e të cilit me punëmarrësin është e barasvlershme me familjen
- Fëmija (fëmija biologjik, i birësuar ose i adoptuar; nga kujdestaria ligjore; fëmija i një punëmarrësi me statusin *in loco parentis*)
- Nipi/mbesa
- Bashkëshorti/bashkëshortja
- Partneri/partnerja shtëpiake
- Prindi
- Gjyshi/gjyshja
- Fëmija ose prindi i bashkëshortit/bashkëshortes ose partnerit/partneres shtëpiake të një punëmarrësi
- Vëllai/motra (duke përfshirë vëllanë/motrën nga njëri prind, të birësuar ose të ardhur me një nga prindërit)
- Çdo individ tjetër me lidhje gjaku me punëmarrësin

NJOFTIMI PARAPRAK:

Nëse nevoja për pushim është e parashikueshme, punëdhënësi juaj mund të kërkojë një njoftim paraprak deri në shtatë ditë përpara për qëllimin tuaj për të përdorur pushimin për arsye sigurie dhe shëndetësore. Nëse nevoja për pushim nuk është e parashikueshme, punëdhënësi juaj mund të kërkojë që ta njoftoni sa më shpejt të jetë praktikisht e mundur.

DOKUMENTACIONI:

Punëdhënësi juaj mund t'ju kërkojë dokumentacion nëse përdorni më shumë se tre ditë pune rresht si pushim për arsye sigurie ose shëndetësore. Ligji "mbi pushimin me pagesë për arsye sigurie dhe shëndetësore" i ndalon punëdhënësit që t'i kërkojnë ofruesit të kujdesit shëndetësor të specifikojë arsyen mjekësore për pushimin për arsye shëndetësore apo që punëdhënësit të kërkojnë dokumentacion për pushimin për arsye sigurie që specifikon detajet e një akti ose kërcënimi të dhunës në familje apo kontaktit seksual kundër dëshirës, të përndjekjes ose të trafikimit të qenieve njerëzore. Zbulimi i këtyre dokumenteve mund të kërkohej nga ligje të tjera.

JU GËZONI TË DREJTËN TË MOS JENI OBJEKT I PENALIZIMIT NGA PUNËDHËNËSI JUAJ PËR SHFRYTËZIMIN E PUSHIMIT PËR ARSYE SIGURIE DHE SHËNDETËSORE.

Punëdhënësi juaj nuk mund t'ju penalizojë për:

- Kërkimin dhe përdorimin e pushimit për arsye sigurie dhe shëndetësore.
- Depozitimin pranë Departamentit të Çështjeve të Konsumatorit (Department of Consumer Affairs, DCA) të një ankese për shkelje të supozuar të ligjit.
- Komunikimin me një person, duke përfshirë kolegët, për ndonjë shkelje të ligjit.
- Pjesëmarrjen në një proces gjyqësor lidhur me një shkelje të supozuar të ligjit.
- Informimin e një personi tjetër për të drejtat e mundshme të atij personi.

Penalizimi përfshin çdo kërcënim, masë disiplinore, shkarkim, ulje në detyrë, pezullim ose reduktim të orëve tuaja të punës, ose çdo veprim tjetër të pavolitshëm punësimi ndaj jush për shkak të ushtrimit apo përpjekjes për të ushtruar çdo të drejtë të garantuar nga ligji.

JU KENI TË DREJTËN TË DEPOZITONI NJË ANKESË.

Ju mund të paraqitni një ankesë pranë DCA-së. Për të marrë formularin e ankesës, vizitoni faqen e internetit nyc.gov/PaidSickLeave ose kontaktoni numrin 311 (212-NEW-YORK jashtë NYC).

DCA-ja do të kryejë një hetim dhe do të përpiqet të zgjidhë ankesën tuaj. DCA-ja do ta mbajë konfidencial identitetin tuaj, përveç rastit kur zbulimi i tij nevojitet për kryerjen e hetimit, për zgjidhjen e ankesës ose kur kërkohet nga ligji.

Ruani një kopje të këtij njoftimi dhe të të gjitha dokumenteve që tregojnë akumulimin e pushimit për arsye sigurie dhe shëndetësore dhe përdorimin e tij.

Shënim: Ligji "mbi pushimin për arsye sigurie dhe shëndetësore" përcakton kërkesat minimale për pushimin për arsye sigurie dhe shëndetësore. Politikat e punëdhënësit tuaj për pushimet mund të përmbushin ose të tejkalojnë kërkesat e ligjit.

Ju gëzoni të drejtën ta merrni këtë njoftim në gjuhën angleze dhe, nëse disponohet në faqen e internetit të DCA-së, në gjuhën tuaj amtare.

Për më shumë informacion, duke përfshirë edhe pyetjet e shpeshta, vizitoni nyc.gov/PaidSickLeave ose telefononi numrin **311** dhe kërkoni informacion për pushimin me pagesë për arsye sigurie dhe shëndetësore.